

UDHËZIM
Nr.11, datë 21.4.2009

**PËR PROCEDURAT DHE AFATIN E HEQJES SË ZGJEDHËSVE QË SHËRBEJNË NË
FORCAT E ARMATOSURA E NË FORCAT E POLICISE SË SHETIT, NGA LISTAT E
ZGJEDHËSVE TË VENDBANIMIT TË TYRE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 60 pika 3, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe afatin e heqjes së zgjedhësve, nga listat e zgjedhësve të vendbanimit të tyre, që shërbejnë në Forcat e Armatosura dhe Forcat e Policisë së Shtetit, që do të ndodhen në vendqëndrimet e tyre në ditën e zgjedhjeve.

Neni 2

Kryetarët e njësive përkatëse të qeverisjes vendore, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pasi verifikojnë nëse zgjedhësit e kërkuar janë në listën e zgjedhësve të asaj njësie, marrin vendim për heqjen e këtyre zgjedhësve nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tyre.

Neni 3

Vendimi hartohet në tri kopje, nga të cilat njëra afishohet së bashku me listën përfundimtare të zgjedhësve, njëra ruhet pranë organit vendimmarrës, së bashku me kërkesën e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe kopja e tretë, brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit, i dërgohet kësaj të fundit.

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ristani